



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2736/1 të datës 16.05.2019, kundër personit ///, në momentin e paraqitjes së kërkesës – anëtar i Këshillit Komunal, **REFUZOHE**T.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për shkak se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare .

Lënda me numër 12 –2736/1 të datës 16.05.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 16 maj 2019 është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i njohur për personin ///, në momentin e dorëzimit të denoncimit - anëtar i Këshillit të komunës /// dhe u formua lënda me numër 12-2736/1 të datës 16.05.2019.

Në denoncim ndaj të cilit ka dorëzuar edhe plotësim, parashtruesi paraqet pretendime të përgjithshme për nepotizëm, përfitime personale, uzurpim të tokës shtetërore dhe ushtrim ndikimi nga i padituri në shërbimet në Komunë /// të cilat dyshohet se nuk kanë vepruar në përputhje me udhëzimet e saj. Njëkohësisht në denoncim ka pretendime për selektivitet në veprimet e të denoncuarit në kryerjen e detyrave zyrtare si punonjës i ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në denoncim nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t'i bërë më konkrete pretendimet e denoncuar, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОРЁ
ПЁР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami

